

Agjencia e Trajtitimit të Koncesioneve (ATRAKO) është institucion publik, buxhetor, me seli në Tiranë, në varësi të ministrit përgjegjës për ekonominë. Buxheti i Agjencisë financohet nga buxheti i shtetit, gjithashtu, dhe nga donatorë të ndryshëm dhe miratohet me buxhetin e ministrisë përgjegjëse për ekonominë, si zë i veçantë.

Misioni i ATRAKO-s është të nxisë dhe të asistojë autoritetet kontraktuese në përgatitjen, vlerësimin dhe negocimin e koncesioneve/ partneriteteve publike private.

ATRAKO ka fushë përgjegjësie ndihmën dhe këshillimin e autoriteteve kontraktuese si dhe sigurimin e standardeve për zbatimin e procedurës së koncesionit, nëpërmjet unifikimit dhe hartimit të modeleve standarde.

Agjencia e Trajtitimit të Koncesioneve (ATRAKO) asiston dhe këshillon Autoritetet Kontraktore në procedurat e dhënies me koncesio/PPP të projektve të mundshme me qëllim:

- a) Përgatitjen e studimit të fizibilitetit;
- b) Përgatitjen e dokumenteve të procedurës konkurruese dhe kriteret e vlerësimit;
- c) Vlerësimin e propozimeve dhe përcaktimin e ofertuesit më të mirë;
- d) Negocimet dhe nënshkrimin e kontratës së koncesionit.
- e) Monitorimin e kontratave të koncesionit;

Gjithashtu Atrako organizon punën për:

- monitorimin dhe analizimin e tendencave aktuale evropiane dhe globale në fushën e koncesioneve/partneriteteve publike private, me qëllim propozimin e ndryshimeve ligjore dhe promovimin e praktikave më të mira ndërkombëtare.
- hartimin dhe unifikimin e modeleve standarde
- për hartimin dhe publikimin e dokumenteve standarde të koncesionit/PPP, në bashkëpunim me APP;
- trajnimin e stafeve, që zbatojnë projekte koncesioni/PPP;
- administrimin e Regjistrimit Elektronik të Koncesionit /Partneritetit Publik Privat (REKP).

Atrako operon në cilësinë e sekretariatit, për Komitetin e Përzgjedhjes së Projekteve të Koncesionit/PPP, në lidhje me shqyrtimin e kërkesave të autoriteteve kontraktuese për mbështetje me ekspertizë të specializuar për kryerjen e oponencës së propozimeve të pakërkuara; për hartimin e studimeve të fizibilitetit/për hartimin e oponencës për studime fizibiliteti.